



- Programi dhe metodologjia e bashkëpunimit trevjeçarë të ASI-t
- Implementimi i politikave gjuhësore të përfshihet në agjendën politike
- Austria e përkushtuar për t'u ardhur në ndihmë institucioneve të Kosovës

Editoriali



Programi dhe metodologjia e bashkëpunimit trevjeçarë të ASI-t

Në fund të mandatit të parë të Kuvendit të Kosovës, ne do të dëshironim që t'ua paraqesim programin dhe metodologjinë e organozatave partnere përbrenda "Iniciativës për përkrahje Kuvendit" (ASI) si dhe disa vrojtime për tri vitet e fundit. Përderisa mungesa e koordinimit të donatorëve është përmendur shpesh si një hendikep serioz i ndihmës ndërkombëtare për shoqëritë në tranzicion, këtu ka pasur një përpjekje substanciale për shmangien e kësaj me fillimin e programeve për ndërtimin e kapaciteteve për Kuvendin e Kosovës. Dhjetë organizata kanë punuar intenzivisht së bashku në gjashtë aktivitetet kryesore ("gjashtë shtyllat"). Ato kishin katër lloje të konsultimeve dhe tri shtresa bashkëpunimi.

Dhjetë organizatat të cilat punuan së bashku në zhvillimin e një programi gjithëpërfshirës të përkrahjes përfshijnë organizatat filiala të Europës, Amerikës dhe të Kombeve të Bashkuara. "ASI" u lind kur Instituti Demokratik Kombëtar (NDI) dhe Departamenti i Demokratizimit të Misionit të OSBE-së në Kosovë së bashku e organizuan konferencën e parë për të gjithë Anëtarët e posazgjedhur të Kuvendit para seancës inauguruese në dhjetor të vitit 2001. Gjatë vitit 2002, iniciativës iu bashkangjitën Friedrich Ebert Stiftung (FES), Friedrich Naumann Stiftung (FNSt.), Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Bearing Point dhe Projekti i praktikës parlamentare lindje-perëndim (EWPPP). Gjatë vitit 2003, Programi i zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP) në bashkëpunim me Unionin ndërparlamentar (IPU), Konrad Adenauer Stiftung (KAS) dhe Projekti i sponsorizuar nga Agjencia Europiane e Rindërtimit (EAR) për përkrahje Kuvendit gjithashtu iu bashkangjitën rrjetit ASI.

Këto dhjetë organizata dhe projekte zhvilluan gjashtë drejtimet kryesore të aktiviteteve, të cilat ne i quajmë "gjashtë shtyllat e ASI-t".

1. Këshillat për komponentat themelore të jetës parlamentare, siç janë roli i grupeve parlamentare, bashkëveprimi ndërmjet qeverisë dhe Kuvendit dhe mbikëqyrja e ekzekutivit, marrëdhëniet me votuesit dhe bashkëveprimin me shoqërinë civile. Një

sërë ngjarjesh dhe konferencash kishin të bënin me këto tema. Kryetarët e Parlamentit të Austrisë dhe Sllovenisë kontribuan sikurse edhe deputetët nga mëse 15 shtete.

2. Këshilla mbi çështjet procedurale, siç janë seminarët trajnuese mbi Rregulloren e Punës (RreP) dhe ndihmesa në rishikimin e RreP. Me kalimin e kohës, ne kemi vërejtur një përputhmëri dhe njohuri më të madhe të RreP. Dëgjimet publike për projektligjet u bënë një pjesë e rëndësishme e procesit legjislativ. Gjithashtu u botua edhe Doracakua për dëgjimet publike.

3. Përkrahja teknike për Komisionet në procesin legjislativ, siç janë këshillat për shqyrtimin e projektligjeve, asistencë në hartimin e amandamenteve, këshilla për pajtueshmërinë e projektligjeve me "Acquis Communautaire" të BE-së. Përkrahje specifike teknike dhe të politikave organizatat e ASI-t kanë ofruar në fushën e ekonomisë, politikave sociale dhe të shëndetësisë dhe në qeverisjen e mirë. Kuvendit iu kanë ofruar këshilla edhe kur është inicuar dhe projektuar legjislacioni i vet. Megjithatë, janë vërejtur mangësi serioze në zbatimin e legjislacionit. Kjo duhet të bëhet prioritet në mandatin e dytë të IPVQ-së.

4. Ndihmesa në vizitat punuese ndërkombëtare të delegacioneve të Kuvendit. Në shumë raste partnerët e ASI-t ndërmorrën qasje të orientuar nga Komisionet gjatë përgatitjes së vizitave jashtë vendit. Pasi që vizitat jashtë vendit janë instrumente të rëndësishme të ndërtimit të kapaciteteve, organizatat e ASI-t u pajtuan që të merren parasysh kritere si përgatitja e duhur dhe përmbajtja e programit të vizitës, përbërja shumëpartiake dhe multietnike e delegacioneve, pa ndërhyrje në obligimet legjislative të anëtarëve dhe relevancën e punës së Komisioneve ose Kuvendit si tërësi. Gjithashtu janë lehtësuar edhe vizitat e delegacioneve të Kryesisë së Kuvendit.

5. Roli dhe pjesëmarrja e komuniteteve jo-shumicë në Kuvend ka qenë përherë në qendër të vëmendjes, duke e përfshirë këtu edhe përkrahjen për grupin parlamentar "Komunitetet e tjera" dhe komunikimin në zhvillim e sipër me "Koalicionin Kthimi" lidhur me praninë e tyre në Kuvend. Është e qartë se rethanat politike kanë pasur ndikim të madh në çfarëdo lloj ndërtimi kapacitetesh të tentuar në këtë drejtim.

6. Këshillat dhe trajnimet e ndryshme për departamentet e ndryshme në Sekretariatit e Kuvendit, në veçanti për Departamentin Ligjor, Departamentin për shtyp dhe informim publik, dhe seksionin e teknologjisë informative (IT). Është themeluar Qendra informative për qeverisje parlamentare. Tanimë ekzistojnë sistemi i menaxhimit të dokumenteve (arkivi elektronik), pajisja për votim elektronik dhe web-faqja e Kuvendit. Programet e posaçme janë duke i adresuar problemet me përkthim.

Për të realizuar projekte specifike përbrenda këtyre "gjashtë shtyllave", ASI ka zhvilluar katër lloje të konsultimeve përmes tri niveleve të bashkëpunimit. Ato janë në qendër të metodologjisë së ASI-t. Konsultimet janë strukturuar përgjatë (1.) konsultimeve të rregullta bilaterale me Sekretariatit e Kuvendit; (2.) takimeve mujore për bashkërendim me të gjithë partnerët e ASI-t, Kuvendin dhe Zyren e Kryeministrit; (3.) takimeve dy-mujore të partnerëve të ASI-t dhe zyrave të ndërlidhjes në Prishtinë lidhur me aspektet

Ligji kundër diskriminimit miratohet nga i Dërguari Special

Katja Chirizzi,

Departamenti I të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të Ligjit, Misioni I OSBE-së në Kosovë.

Më 20 gusht 2004, I Dërguari Special miratoi Ligjin kundër Diskriminimit, të miratuar më par; nga Kuvendi i Kosovës më 30 korrik. Kuvendi i Kosovës fillimisht kishte miratuar ligjin më 19 shkurt 2004. Dhe si rrjedhim Koalicioni Kthimi përmes një propozimi sipas Kornizës Kushtetuese kishte sfiduar miratimin e ligjit. Procedura sfiduese, një ekspeditë, u vonua për arsye të bllokadës në emërimin e tre anëtarëve të panelit përgjegjës për zgjedhjet e rekomanduara të Kuvendit. Më 14 dhe 15 korrik Paneli Special u mbledh dhe morri vendimin unanim që përmbante shtatë rekomandime.

Ligji rrjedh nga ligji gjithëpërfshirës kundër diskriminimit i draftuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të Ligjit dhe iu është dorëzuar Institucioneve të Kosovës në shtator të vitit 2002. Misioni i OSBE-së është lobuar fuqishëm për miratimin e një ligji të tillë

dhe u ka dhënë IPVQ-ve këshilla juridike gjatë gjithë kohës së përgatitjes së këtij ligji.

Ligji është në interes të tre funksioneve. Fillimisht, konsolidon dhe përforcon ligjin ekzistues kundër diskriminimit duke e harmonizuar me standardet ndërkombtare dhe europiane kundër diskriminimit.

Së dyti, promovon uniformitet në dënimeve e formave të ndryshme të diskriminimit, përfshirë edhe diskriminimin në punësim, në qasje në shërbimet themelore (shërbime publike dhe të asistencës sociale, arsimim, siguri shoqërore, furnizim dhe shërbime të tjera). Ligji mbron grupe të ndryshme të rrezikuara, përfshirë minoretet entike, fetare dhe gjuhësore, grate, fëmijët dhe personat me të meta fizike dhe psikike.

Dhe së fundi, ofron kompenzime efektive juridike dhe administrative për viktimat të çfarëdo lloji të diskriminimit dhe sanksionime

efektive dhe proporcionale për tju adresuar përdhunimeve në sektorin privat dhe publik.

Dhe derisa po shprehim kënaqësinë tone për miratimin final të ligjit, ngelin akoma shqetësime për rekomandimin e pestë të Vendimit të Panelit (ku është fshirë neni I 11 dhe 12 I Ligjit në fjalë për formimin e Qendrës për trajtim të barabartë). Një rekomandim i tillë në fakt zbehet përputhshmërinë e Ligjit me standardet europiane dhe ndërkombtare.¹

Misioni I OSBE-së me këtë rast mbështet ftesën e Kuvendit të Kosovës, të përfshirë në rekomandimin e gjashtë të Vendimit 'për të marrë çfarëdo mase shtesë të nevojshme për të siguruar që ligji në fuqi është në përputhje të plotë me normat dhe standardet europiane dhe ndërkombtare.'

Në ndërkohë, OSBE-ja për momentin është përfshirë në procesin e paraparë të implementimit të fushatës për



Katja Chirizzi

vetëdijen publike të nga qeveria para se të hyjë në fuqi – një muaj pasi që të jetë miratuar. Për më shumë, ne do të përcjellim të gjitha hapat e nevojshëm për një implementimin sa më të suksesshëm të ligjit.

¹ Ligji ka për model ligjvënës Udhëzimin e Këshillit Europian 2000/43/ (udhëzimi për Barazi Racore), Udhëzimin e BE-së 2000/78/EC (Për vendosjen e një kornize të përgjithshme në punësim dhe profesion), dhe Neni 26 të Konventës Ndërkombtare për të drejtat politike dhe qytetare.

politike të programeve të ASI-t; (4.) takimeve të brendshme javore me partnerët kryesorë dhe kontaktet ditore bilaterale. Këto katër lloje të konsultimeve kanë siguruar që të gjitha palët e interesuara të informohen dhe përfshihen, dhe aktivitetet mund të drejtohen, të bëhen më gjithëpërfshirëse dhe që të shmanget dyfishimi i mundshëm i aktiviteteve.

Gjatë vitit të kaluar u bë e qartë se ekzistojnë tri nivele të bashkëpunimit. Ndërveprimi midis organizatave të ASI-t mund të vendoset në nivele të ndryshme, varësisht nga prioritetet e programit, interesat, besimi dhe vullneti për të bashkëpunuar. Niveli i parë i bashkëveprimi është shkëmbimi i informatave. Që të gjitha organizatat ishin pjesë e këtij niveli, me shkallë të ndryshme të ndarjes së informatave. Shkalla e dytë e bashkëpunimit është zhvillimi i aktiviteteve plotësuëse, duke i ikur dyfishimit të punës dhe puna drejt ndarjes së punëve sipas marrëveshjeve të mëhershme. Forma

e tretë dhe më intensive e bashkëveprimi midis organizatave të ASI-t ka qenë zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta, qasja e përbashkët dhe pikëpamja e përbashkët për programet. Si koordinator i ASI-t, Departamenti i Demokratizimit i OSBE-së ka tentuar që të bashkëveprojë me partnerët në këto tri nivele dhe që ta lehtësojë një program gjithëpërfshirës të përkrahjes për Kuvendin, duke pasur parasysh se koordinimi i donatorëve duhet të ndërtohet në bazë të angazhimit vullnetar të të gjithë partnerëve.

Gjatë mandatit të parë të Kuvendit (2001 – 2004), ne e kishim mundësinë që të jemi pjesë dhe të kontribuojmë në përvojën unike të ndërtimit të një institucioni krejtësisht të ri. Prej tash e tutje, reforma e institucionit

Franklin De Vrieze,

Koordinator i Inicativës për përkrahje të Kuvendit.

Beneficione për ata që vuajtën

Gjatë mbledhjes plenare të mbajtur më 16 – 18 qershor 2004, Kuvendi i Kosovës gjatë leximit të pare derisa votonin për të ndërruar emrin e draft Ligjin. Vlerësoi pozitivisht draftin e "Ligjit mbi të Drejtat e e pjesëmarrësve të luftes së UÇK ë familjeve të dëshmorëve dhe Viktimave të Luftës " Artikulli në vijim pasqyron mundësinë për të miratuar ligjet në përputhje me të drejtat e njeriut për beneficione për veteranët e luftës.

Hjortur Sverrisson,

Koordinator i Njësisë për analiza dhe raport pranë Departamentit të të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të Ligjit, Misioni i OSBE-së, në Kosovë.



Hjortur Sverrisson

Pas konfliktit të armatosur shpesh ndihet nevoja e njohjes së sakrificave të atyre që rrezikuan jetërat e tyre në luftë për idealet e tyre, për familjet e tyre dhe popullin e tyre. Fatkeqësisht, shumica e konflikteve të armatosura lënë pas shumë të plagosur, ushtarë dhe civil të vrarë, si dhe familjarë që kanë humbur më të dashurit e tyre ose që kanë nevojë për të rindërtuar ardhmërinë e tyre për shkak të pamundësisë së fitimit të të ardhurave. Nevoja për ti ndihmuar ata që vuajtën janë component e rëndësishme e shoqërive të pas-konfliktit dhe pjesë e natyrshme e procesit të shërimit të plagëve.

Është e natyrshme që shoqëritë e paskonfliktit pësuan humbje të mëdha si pasojë e luftës të gëzojnë beneficione speciale. Qysh në vitin 1789 SHBA-të miratuan ligje që mundësuan dhënien e pensioneve invalidore oficerëve pjesëtarë të Luftës revolucionare dhe beneficione të vejava për të vdekurit e tyre. Edhe pas Luftës Qytetare në SHBA në gjysmën e dytë të shekullit të 19-të u miratuan ligje të ngjajshme.

Në një shoqëri që po shërohet nga konfliktet e mbrendshme etnike, dhe ku njëra palë përceptohet të jetë fituesi, shumë çështje të pazgjedhura dalin në shesh. Çfarë ndodh me ata të cilët nuk kanë vizionin e fitorës edhe pse kanë vuajtur gjatë konfliktit? Pastaj, a do të duhej të jepeshin beneficione vetëm pales që I takonte një grupi të caktuar të armatosur apo edhe civilëve? Pastaj, kush duhet të vendos kujt ti jepen këto beneficione. Dhe çfarë është më e rëndësishmja, kush mund të dale në një shoqëri të pas-konfliktit me një skemë për të gjithë të përvuajturit, e cila sipas standardeve moderne të të drejtave ndërkombtare të njeriut nuk përjashton komunitetet që nuk kanë ndjenjën e fitorës?

Në asnjërin nga këto pyetje nuk është lehtë të përgjigjet. Dhe posaqërisht pyetja e fundit është e vështirë për tju adresuar. P.sh beneficione për veteranët e luftës të cilat janë një mbështetje e njëanshme për qytetarët lehtë mund të bie në kurthën e diskriminimeve dhe të jetë kontraproduktive për një shoqëri në tranzicion pas konfliktit. Është vitale për marrëdhëniet ndër etnike, zhvillimet e mëtur-jeshme në Kosovë si dhe përputhshmërinë e saj me kushtet e integriteteve europiane, që të sigurojë që ligji për beneficione veteranëve të luftës të jetë në përputhje me të gjitha parimet, përfshirë këtu edhe ato kundër diskriminimit. Është gjithashtu e rëndësishme për kredibilitetin e skemës në fjalë, mes kosovarëve në përgjithësi, të sigurohet që ligjet e tilla të përmbajnë nene për pranueshmërinë, të ofrojnë

procedura transparente dhe të jenë konform kushteve të proceseve të ardhshme.

Por çfarë janë opcionet e hartuesve të këtyre ligjeve këtu në Kosovë? Në fakt ekzistojnë disa opsione, disa të mira dhe disa jo aq të mira. Fillimisht, ligjet e tilla duhet përpiluar në mënyrë që të përfitojnë vetëm një grup kryesorë I luftëtarëve invalidë dhe familjeve të mbijetuarve: Kriteret e atyre që kualifikohen duhet bërë të qarta me ligj, dhe procesi I dhënies së beneficioneve duhet të jetë transparent dhe të mundësojë shqyrtimin e vendimeve nga një trup për parashtrësia. Vlerësimi I invaliditetit duhet bazuar në fakte mjekësore. Evidenca e shkaqeve të lëndimeve duhet të jetë I bazuar në rregjistra me shkrim, dëshmi të komandatëve apo liderë të njëjësive, apo burime të tjera të besueshme. Ky opcion, varësisht nga elaborimi I mëturjeshëm dhe implementimi, do të mund të bëhej konform me standardet ndërkombtare të të drejtave të njeriut dhe kushtet e proceset në të ardhmën. Ndonëse do të kontribuonte fare pak në afrimin e komuniteteve të ndryshme.

Një opcion tjetër për të definuar kriteret më gjerësisht dhe për ti bërë ato 'etnikisht-neutral', p.sh të krijojnë një skemë ku do të përfitonin jo vetëm ata që luftuan për çlirimin e Kosovës por edhe të civilëve që pësuan lëndime apo humbën më të dashurit e tyre në luftë , pavarësisht cilit grup etnik i takojnë. Ideja prapa kësaj qëndron në atë që të gjithë vuajtën, që lufta është armiku vet, dhe se të gjithë meritojnë

mirënjohje. Kjo qasje, pasi të jenë plotësuar të gjitha kushtet e parapara, do të ketë më shumë gjasa të jetë konform standardeve ndërkombtare të të drejtave të njeriut. Do të kontribuonte gjithashtu edhe drejt integritet të komuniteteve minoritare në Kosovën e së ardhmes. Vësh-tirësia më e madhe do të jetë sigurimi i qëndrueshmërsë financiare.

Dhe opioni më i keq, do të jetë skema ku do të përfitonin grupe ushtarësh dhe civilë vetëm të një grupi etnik, pa procedura të qarta të vlerësimit të invaliditetit apo pranueshmërisë, dhe pa të drejtën e ankesave kundër vendimeve të marra. Një qasje e tillë do të tëhuajzonte komunitetet të cilat do të duhej të merrnin pjesë në rindërtimin e Kosovës e pas-konfliktit. Do të mund të krijohej një ambient rezistues ndaj korrupcionit. Në të kundërtën nuk do të arriheshin standardet ndërkombtare dhe kësajsoji ligjet e tilla do të humbnin kredibilitetin që do të duhej të kishin në mesin e kosovarëve. Dhe për ironi do të shkelte parimet kundërdiskriminimit, mu atë parim për të cilin përfituesit e skemës luftuan.

Si në shumë pyetje të tjera sfi-duese, u ngelet kosovarëve që të japin përgjegje në to , dhe jo prezencës ndërkombtare në Kosovë, shteteve të Kuinitit apo grupit të Kontaktit. Varet nga vet kosovarët nëse skema në fjalë do të jetë në harmoni me vizionin për një Kosovë tolerante, apo do të promovonte diskriminim dhe mungesë të tolerances siç bëri rregjimi ikaluar. Për fat të mirë, zgjedhja lehtë mund të bëhet.

Magësitë në zbatimin e Ligjit mbi qasjen në dokumentet zyrtare

Misioni i OSBE-së në Kosovë ka shprehur shqetësimin e vet lidhur me zbatimin joadekuat të dispozitave të Ligjit mbi Qasjen në Dokumentet Zyrtare nga ana e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ), në nivelin qendror, i cili hyri në fuqi me 6 nëntor të vitit 2003.

Kontribut nga Divizioni i Sundim të Ligjit, të Departamentit për të Drejtat e Njeriut dhe Sundim të Ligjit të OSBE-së, Raporti Javor.

Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin mbi Qasjen në Dokumentet Zyrtare me qëllim që t'ua bëjë të mundur qytetarëve të Kosovës, që të jenë më afër procesit të vendim marrjes në institucionet publike. Kjo është një mënyrë për të siguruar që institucionet publike të kenë legjitimitet dhe transparencë më të madhe dhe njëherësh të jenë më të efektshme dhe më të përgjegjshme ndaj atyre që u shërbejnë.

Ca nga dispozitat e këtij ligji parashohin edhe masat që duhet të ndërmerren për të vënë në jetë këtë Ligj. Këto dispozita i referohen dy adresave: Qeverisë dhe institucioneve. (Sipas interpretimit më të gjerë me fjalën "Institucione" mund të nënkuptojmë të gjitha organet dhe agjencitë e IPVQ-ve, AKM-në, organet dhe agjencitë komunale, si dhe organet dhe zyrat e pavaruara të përfshira në listën e Kapitullit 11 të Kornizës Kushtetuese).

Fjala vjen, sipas Paragrafit 4.3 parashikohet që Qeveria të përgatisë listën e dokumenteve që do të trajtohen si dokumente të ndjeshme; Paragrafi 17.1 parasheh që Qeveria të miratojë rregulla dhe procedura adekuate lidhur me klasifikimin e dokumenteve konfidenciale, gjastëdhjetë ditë pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji; Paragrafi 16.2 përcakton që Zyra e Kryeministrit (ZKM), më së voni deri me 31 korrik 2004 dhe çdo vit pas kësaj date, të publikojë një raport, dhe të sigurojë një kopje të raportit për dosje Kuvendit të Kosovës, mbi vënien në jetë të këtij Ligji.

Veç kësaj, në dispozitën e Paragrafit 10.3 të këtij Ligji bëhet

fjalë edhe për obligimin e institucioneve që të marrin masa të nevojshme për të përgatitur një regjistër, i cili do të duhej të ishte i gatshëm deri me 1 janar 2004. Një regjistër i këtillë duhet të përmbajë edhe emrat e dokumenteve që sigurohen nga institucionet dhe lokacione e tyre përkatëse; Sipas Paragrafit 8.1 të këtij Ligji dokumente sensitive janë ato dokumente që krijohen dhe burojnë nga institucionet, e që janë klasifikuar si të atilla konform rregullave të institucionit përkatës dhe të cilat mbrojnë interesat e IPVQ-ve. Mirëpo, këto rregulla duhet të bëhen publike.

Gjatë periudhës qershor – gusht 2004, Misioni i OSBE-së në Kosovë – Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Sundim të Ligjit ka mbajtur disa mbledhje për të diskutuar rreth zbatimit të Ligjit mbi Qasjen në Dokumentet Zyrtare, me përfaqësuesit e departamenteve ligjore të këtyre institucioneve: Zyrës së Kryeministrit (ZKM); Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale; Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Ministrisë së Shërbimeve Publike; Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve; Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit; Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Ministrisë së Shëndetësisë; dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Së pari, vlerësohet se afatet e përcaktuara me Ligj nuk janë respektuar. Fjala vjen, ZKM-

ja nuk ia ka dalur mbanë që ta publikojë një raport deri me 31 korrik 2004 përkitazi me zbatimin e këtij Ligji. Asnjëra nga institucionet e sipërpërmendura nuk kanë përgatitur regjistra, të cilët do të duhej të ishin në dispozicion deri me 1 janar 2004. Pos kësaj, Qeveria ende nuk i ka miratuar rregullat dhe procedurat, që do të përcaktonin kriteret për klasifikimin e dokumenteve konfidenciale, gjë e cila duhej të ishte bërë deri me 5 janar 2004. Së dyti, Qeveria nuk e ka përmbushur obligimin e vet që del nga Paragrafi 4.3 i Ligjit për të përgatitur një listë të dokumenteve, që do të duhej të trajtoheshin si sensitive.

Vlen të vihet në dukje se ka pasur gjithnjë projekte për mbështetjen e IPVQ-ve për të implementuar këtë Ligji. Kështu, në shkurt të vitit 2004 Instituti Nacional Demokratik (NDI), organizoi një trajnim mbi Ligjin për deputetë të Kuvendit të Kosovës, zyrtarë të ministrive, dhe përfaqësuesë të komunave. Njëherazi, NDI-ja në Kosovë ka përgatitur, në bashkëpunim me Iniciativën për Mbështetjen e Kuvendit të OSBE-së një doracak për implementimin e Ligjit, i cili përmban sqarime të tekstit të secilit paragraf të Ligjit. Doracakun përmban edhe disa modele të aplikimit, që mund të shërbejnë edhe si shembujë me rastin e paraqitjes së kërkesës për qasje në dokumente zyrtare. Duhet theksuar se Misioni i OSBE-së i përkrah nismat e këtilla. Së këndejmi, mbetet që strukturat e IPVQ-ve t'i vëjnë në jetë këto njohuri.

Kuvendi i Kosovës në të ardhmen

mbase mund të kërkojë nga Qeveria një raport mbi zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumentet Zyrtare, sipas paragrafit 16.2 të Ligjit; dhe që IPVQ-të në nivelin qendror t'u përmbahen obligimeve që dalin nga Ligji për Qasje në Dokumentet Zyrtare, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

FES organizon konferencë mbi implementimin e ligjeve

Është e udhës të vihet në dukje se gjatë mandatit të parë të këtij legjislacioni janë miratuar një numër mjaft i madh i draftligjeve. Megjithatë, është me rëndësi të shihet se çfarë ndikimi ka pasur kjo veprimtari legjislative e Kuvendit. Çfarë ndodhi me ligjet pas shpalljes së tyre? A i kanë arritur ato parashikimet dhe qëllimet e pritura? A janë të njoftuar me këto ligje qytetarët, politikanët dhe shërbyesit civilë në komuna dhe në ministri? A është duke u mësuar për këto ligje në fakultete të drejtësisë dhe a janë duke u aplikuar në gjykata?

Këto janë ca nga çështjet që do të diskutohen në një konferencë, e cila do të organizohet nga Fridrih-Ebert-Shtiftung (FES) dhe OSBE-ja, të mërkurën me datë 29 shtator. Në këtë konferencë janë ftuar palët e interesuara nga Kuvendi, Qeveria, komunat dhe gjyqësori, jo vetëm për ta shqyrtuar situatën aktuale në zbatimin e ligjeve, por edhe për të diskutuar për rekomandimet.

Projekti mbështetës i AER-it për procesin legjislativ: Puna me komisione në "acquis communautaire"

Virtyt Ibrahimaga, LL.M. Eur.,
Ekspert i Lartë Ligjor në projektin e AER "Mbështetje Kuvendit të Kosovës"



Virtyt Ibrahimaga

Gjatë dy viteve të fundit, procesi i harmonizimit të legjislacionit të Kosovës me të arriturat ligjore të BE-së po shënon progres të konsiderueshëm. Kjo shihet qartë nga fakti Kuvendi i Kosovës këtë vit ka miratuar pjesë të legjislacionit të BE-së nga fusha shumë të rëndësishme si ato kundër diskriminimit, barazisë gjinore, mbrotjen e konsumatorëve, transportit të mallërave të të rrezikshme dhe standardizimit të produkteve.

Baza ligjore për harmonizimin gjendet në Paragrafin 5.7 të Kornizës Kushtetuese [Rregullorës së UNMIK-ut 2001/9]. Dhe ky nen përcakton përgjegjësinë që kanë IPVQ-të për harmonizimin e legjislacionit me standardet europiane. Në takimin e parë të ashtuquajturit PSA (procesit të asociim stabilizimit) Mekanizmeshoqëruese, IPVQ-të dhe UNMIK-u u përkushtuan që të ndërministrin masa për të siguruar shqyrtimin e legjislacionit me standardet e BE-së para miratimit të ligjit. Në takimin e tretë

të Mekanizmit Shoqërues të PSA-së për Kosovë, UNMIK-u dhe IPVQ-të u përkushtuan të kryejnë një kontroll kompatible të legjislacionit, që ka për objektin përforcimin e afërsisë së legjislacionit kosovar me "rregullat dhe Standardet e BE-së".

Rregullat dhe standardet e BE-së njihen si *acquis communautaire*. Tërë korniza e ligjeve europiane njihet me termin *acquis communautaire*, që përfshin të gjitha traktet, rregulloret dhe udhëzimet e miratuara nga institucionet europiane, si dhe vlerësimet e bëra nga Gjykata e Drejtësisë. Aq më shumë, të ashtuquajturat Marrëveshjet Europiane theksojnë rëndësinë e harmonizimit të legjislacionit në procesin e asociimit, dhe si hap të ardhshëm bashkimin në Unionin Europian.

Procesi është tejet ambicioz. Nënkupton ngajshmerinë apo unifikimin e legjislacionit në shumë lëmitë si ato të transportit, sigurisë, energjisë elektrike, shëndetësisë, drejtësisë, bujqësisë arsimi deri diku, si dhe harmonizimit me praktikën europiane. Kjo nënkupton që vendet candidate, përveq miratimit formal të legjislacionit në përputhje me *acquis communautaire*, duhet ndërmarrë masa konkrete për të implementuar legjislacionin e miratuar. Dhe për këtë, harmonizimi i sistemit ligjor vendor me legjislacionin europian është njëra nga sfidat kryesore në procesin e integritetit europian. Kërkon ndërmarrjen e një sërë masash politike dhe ligjore, si dhe koordinim dhe monitorim të

procesit të harmonizimit ligjor. Për shkak të kompleksitetit të të natyrës, shumë vende candidate kanë vënë përgjegjësinë e koordinimit dhe monitorimit të procesit të harmonizimit në një Ministri të veçantë si Ministria për Integritet Europian.

Ky proces në Kosovë është në fazën e saj fillestare. Dhe në këtë aspekt IPVQ-ja po bështetet nga disa projekte të AER-it. Projekti I financiar nga AER-I "Mbështetje Kuvendit të Kosovës" është duke mbështetur Kuvendin në miratimin e praktikave më të mira të BE-së, dhe njëkohsisht harmonizimin me *acquis communautaire*, me kushtet e parapara të Procesit të Asociim Stabilizimit. Projekti I BE-së - Mbështetje Kuvendit të Kosovës është lansuar në vitin 2003 dhe do të përfundojë në fillim të vitit 2005.

Harmonizimi i legjislacionit me *acquis communautaire* është një prej aktivitetet kryesore të Projektit. Çdo projektligj I paraqitur në Kuvend duhet të jetë në përputhje me *acquis communautaire*, kornizën e përgjithshme ligjore në Kosovë, në veqanti me Kornizën Kushtetuese, të drejtat dhe interat e komuniteteve. Sidoqoftë, sa i përket parimeve të ndarjes së pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, Kuvendi i Kosovës ka nevojë të krijojë kapacitete për një kontroll legjislativ të pavarur duke patur parasysh parimet e lartpërmendura. Kontrolli i përputhshmërisë për momentin po bëhet përmes Ekspertit të Lartë Ligjor të Projektit dhe Zyrtarit të Lartë Juridik pranë

Kuvendit, z. Defrim Krasniqit. Është paraparë që të krijohet një Njësi e përhershme e kontrollit të përputhshmërisë. Dhe për këtë qëllim Kuvendi planifikon të punësojë zyrtarë të tjerë ligjorë.

Ndonëse, ky projekt mbulon nevojën imediate për një kontroll direkt të legjislacionit në fazën e amendamentimit apo draftimit duke pasur për qëllim përforcimin e kapaciteteve të stafit të Kuvendit. Projekti parasheh gjithashtu edhe trajnime gjatë muajit të dhjetorit 2004 për përgatitjen dhe rishqyrtimin e legjislacionit, me theks të veçantë në *acquis communautaire*.

Për momentin, projekti punon ngushtë me të katër komisionet parlamentare. Sapo të marrë komisioni projekt-propozimin, Zyrtari i Lartë Ligjor ose eksperti i jashtëm përgatit ekspertizën teorike mbi çështjen e rregulluar. Ekspertiza u shpërndahet anëtarëve të komisioneve përkatëse dhe stafit mbështetës të komisionit në fjalë. Ekspertiza përmban informacionet dhe konkluzat që i përkasin dobësisë dhe jopërputhshmërisë me *acquis communautaire*, Kornizën Kushtetuese dhe legjet e aplikueshme. Në takimet e komisionit konkluzionet e ekspertit ligjor diskutohen hapatazi. Projekti merr pjesë në takimin e komisionit për të qenë në mundësi të shpjegojnë dhe demonstrojnë në detaje rekomandimet e Projektit. Dhe kur komisioni vendos të amendamentojë projekt-propozimin të jetë në përputhje me rekomandimet e Projektit, Projekti mëpastaj asiston stafin

e komisionit të përgatisin amendamentet përkatëse. Pas miratimit të projekt-ligjit nga ana e komisionit parlamentar, projekti përgatit raportin final për dorëzimin e projekt-ligjit në Departamentin Ligjor. Raporti final përmban konkluzionet për përputhshmërinë gjegjësisht jopërputhshmërinë e ligjit me burimet e para BE-në, Legjislacionin e BE_së (burimin e dytë) Konrizën Kushtetuese, legjislacionin ekzistues dhe asyret e mundshme për përputhshmëri apo jopërputhshmëri të pjesërishtme.

Projekti nuk ndikon në vendimin e anëtarëve të komisionit. Vendimi i pranimit apo refuzimit të rekomandimeve ngelë tek anëtarët e komisionit.

Duhet pranuar që puna në legjislacion në nivel parlamentar nuk është fare i lehtë. Një numër i madh i projekt-propozimeve nuk janë të cilësishë së lartë. Dhe as në përputhje me Konrizën Kushtetuese dhe acquis communautaire-n. Përputhshmëria e legjislacionit me acquis communautaire nuk është e garantuar në fazën kur projekt-ligji dorëzohet në Kuvend për miratim, në rast se sponsoruesi nuk është përpjekur të përfshijë së paku udhëzimet e BE-së mbi projektligjin e caktuar. Koha për miratimin e ligjit në Kuvend është e kufizuar. Përveq kësaj, për shkak të kërkesave të larta të Legjislacionit European, nganjëherë mungon gatitshmëria e disa anëtarëve të komisionit, posaqërisht mbrenda komisioneve që merren me çështje të tregtisë të mbështesin përputhshmërinë e plotë të legjislacionit me acquis communautaire.

Dhe në fund fare, ekzistojnë disa parime për procesin e harmonizimit të legjislacionit me acquis communautaire, duke patur parasysh të metat e projektligjeve të dorëzuara

në Kuvend, vështirësive për të filluar procesin e harmonizimit pas dorëzimit të projektligjeve nga sponsorët, mundësitë e kufizuara të Kuvendit për të inicuar harmonizimin e legjislacionit.

- Që mekanizmat për kontrollimin të përputhshmërisë së legjislacionit të draftuar me acquis communautaire, të vendosen mbrenda ministrive kryesore.
- Për shkak të natyrës tejte komplekse, koordinimi dhe monitorimi i procesit të harmonizimit ligjor do të duhej të kryhej nga një agjension apo ministri. Dhe meqë harmonizimi bëhet përmes organeve të ndryshme, shpejtësia dhe cilësia e rezultateve varen në rradhë të pare nga koordinimi i atyre aktiviteteve.
- Sponsoruesi i Ligjit do të bashkangjesë me të edhe tabelën e përputhshmërisë të ligjit me Konrizën Kushtetuese dhe acquis communautaire-n.
- Pasi që harmonizimi i legjislacionit me acquis communautaire pasohet gjithnjë me një shumë të caktuar financiare, sponsorin I draft legjislacionit do të duhej të bashkangjiste edhe deklaratën e hargjimeve që ka të bëjë me implementimin e Aktit.
- Sponsoruesi i projektligjit do të duhej të përfshijë edhe nenet për autoritetet deleguese dhe Aktet Implementuese.
- Është me rëndësi të veçantë, që në të ardhmen të krijohet një komision parlamentar special ad hoc (jo domosdoshmërisht permanent), detyra e të cilit do të ishte të kontrollojë të gjitha ligjet, ndonëse të ndryshme në essence, të kenë denominator që kanë për qëllim harmonizimin e legjislacionit të Kosovës me acquis communautaire.

Lajme shkurt

Internet kafeja në Kuvend dhe trajnimi në ECDL

Që nga 1 shtatori, deputetët e Kuvendit të Kosovës do të kenë mundësi që t'i shfrytëzojnë kompjuterët në "Internet kafenë e Kuvendit". Bëhet fjalë për projektin SPEAK në mbështetje të Kuvendit të Kosovës, për të cilin janë siguruar tetë kompjuterë dhe një printer. Instalimi i kompjuterëve ka për qëllim që t'u vijnë në ndihmë parlamentarëve gjatë punës së tyre të përditshme, duke ua bërë të mundur një qasje më të lehtë dhe më të shpejtë në Sistemi i Ri i Menaxhimit të Dokumenteve, i cili është instaluar dhe është në përdorim si një sistem i testimit. Veç kësaj, projekti SPEAK me qëllim të aftësimit të deputetëve të Kuvendit ka organizuar një seri trajnimesh për kompjuter në ECDL (Licensimi Evropian për Punë me Kompjuter), duke shpresuar se deputetët do t'i ndjekin këto trajnime. Për më tepër informata mund të kontaktoni me z. Ali R. Cakën, Zyrtar Vendor i Projektit SPEAK për Mbështetje të Kuvendit të Kosovës. E-mail-i: ali.caka@undp.org

NDI vazhdon të përkrahë Kuvendin

Instituti Nacional Demokratik (NDI) ka planifikuar një sërë aktivitesh me deputetët e Kuvendit deri në fund të vitit 2004. Me kërkesë të një grupi parlamentar, NDI do të sigurojë asistencë ligjore për hartimin e Rregullores së Punës mbi funksionimin e grupeve parlamentare. Njëherësh, NDI-ja është duke organizuar dhe mbajtur konsulta me deputetët dhe Sekretariatit e Kuvendit me qëllim të avansimit të aktiviteteve që kanë të bëjnë me marrëdhëniet me zgjedhësit. NDI-ja është duke punuar me Komisionin përkatës të Kuvendit dhe përfaqësuesit e Qeverisë për të siguruar zbatimin efikas të Ligjit mbi Qasjen në Dokumentet Zyrtare. Pos kësaj, në bashkëpunim me partnerët e tjerë të ASI-it, NDI-ja do të përkujdeset për Trajnimin Orientues të Deputetëve të Rinj. Me këtë rast, NDI-ja do të përqëndrohet në disa tema, si: Njohja me Rregulloren e Punës së Kuvendit, përgatitja dhe mbajtja e seancave dëgjimore, dhe ndoshta edhe në marrëdhëniet me zgjedhësit, mbikëqyrjen e ekzekutivit, dhe komunikimin për ligjvënësit. NDI-ja do të organizojë edhe një seminar me anëtarët e Kuvendit mbi shqyrtimin, ndryshimin dhe hartimin e legjislacionit. Për më shumë informata mund të kontaktoni me z. Edmond Efendijën, në email-in: eefendija@ndikv.org

Falemnderit, Hethër !

NDI në Kosovë bën të ditur se drejtoreshës së gjerëtanishme të NDI-së, znj. Hethër Kashner, ngadalë po i afrohet fundi i misionit të saj mjaft të sukseshëm. Duke shërbyer në Kosovë për më tepër se tri vite, znj. Kashner ka pasur nderin dhe kënaqësinë që të japë kontributin e saj të çmuar për mbështetjen e zhvillimeve demokratike në Kosovë.

Pritet që drejtori i ri, z. Tom Bridle të arrijë në Kosovë deri në fund të tetorit 2004. Ekipi i NDI në Kosovë ka kënaqësinë që t'i dëshirojë mirëseardhje z. Bridle. Në shpresojmë se përvoja e tij e begatë në kongresin e SHBA-ve dhe me parti politike, si dhe përvoja e tij në vendet në tranzicion të Evropës dhe Azisë Lindore dhe Qendrore, do të jetë jashtëzakonisht e dobishme për partnerët tanë.



Partneri i ri i cili do ta afrojë Kosovën me BE-në

Rafael Peralta,
Zyrtar për çështje politike në Zyren Europiane, UNMIK shtylla e BE-së.

Samiti Bashkimi European (BE)-Ballkani Perëndimor i mbajtur në Selanik në qershor të vitit 2003, shënoi një hap të rëndësishëm në thellimin e marrëdhënieve midis BE dhe Ballkanit perëndimor. Në këtë samit, perspektiva për anëtarësimin në BE të Ballkanit perëndimor jo vetëm që e ritheksua, por edhe u paraqitën mekanizma të rinj përkrahës për ta përhshpejtuar realizimin e kësaj perspektive. Këto masa të reja përkrahëse, të cilat janë treguar në të ashtuquajturën "Agjendë të Selanikut për Ballkanin perëndimor", janë modeluar sipas atyre që janë shfrytëzuar nga BE për t'i përkrahur përpjekjet e shteteve kandidatë për harmonizimin e legjislacionit, politikave, kapaciteteve administrative dhe ekonomike të tyre me standardet europiane.

Njëri prej mekanizmave të rinj që i është dhënë në dispozicion Ballkanit perëndimor është ATSHI, që është shkurtësë për Njësitin për asistencë teknike dhe shkëmbim të informatave të Drejtorisë së përgjithshme për zgjerim të Komisionit European. Që nga 1996, ATSHI ka siguruar asistencë teknike afat-shkurtër për shtetet kandidatë në fushën e harmonizimit, zbatimit dhe fuqizimit të legjislacionit. Kosovës dhe pjesës tjetër të Ballkanit perëndimor i është ofruar zyrtarisht në pranverë të vitit 2004 që t'i shfrytëzojnë shërbimet e ATSHI. Prej qershorit të vitit 2004, ATSHI ka organizuar më shumë se 20 seminare për zyrtarët nga Kosova dhe pjesa tjetër e regionit. Këto seminare kishin të bënin me një numër të madh të lëmive që nga agrokultura e deri te mjedisi

apo prokurimi publik. Është paraparë që edhe seminare të tjera të organizohen nga ATSHI në muajt vijues, duke e përfshirë këtu edhe një për personelin e Kuvendit.

Asistenca e ATSHI në shumë aspekte dallon nga ndihma që është duke iu ofruar Kosovës. Fillimisht, ATSHI ka të bëjë vetëm me çështjet të cilat janë të ndërlidhura me harmonizimin e legjislacionit vendor me legjislacionin e BE-së, të ashtuquajturën "Acquis Communautaire të BE-së", si dhe me problemet me të cilat përballen gjatë zbatimit të legjislacionit të BE-së. E dyta, ATSHI nuk u ofron asistencë vetëm shërbyesve civil që punojnë në të gjitha nivelet e administratës publike, por edhe anëtarëve të Kuvendit dhe personelit të Kuvendit, shoqatave që përfaqësojnë partnerët social, autoriteteve për zbatime juridike dhe ligjore, sikurse edhe përkthyesve, redaktorëve, dhe përkthyesve të teksteve legjislative. Veçoria e tretë dalluese e asistencës së ATSHI është se ajo mbështetet vetëm në shërbyesit civil që vijnë nga administratat kombëtare të shteteve anëtare të BE-së. Në rastet kur seminare mbahen në Bruksel, mund të marrin pjesë edhe zyrtarët nga Komisioni European. E katërta, shërbimet e ATSHI në përgjithësi jipen pas kërkesës, ose me fjalë tjera, pjesa më e madhe e asistencës së ofruar jipet pas kërkesës nga përfituesit.

ATSHI e jep ndihmën e vet përmes disa shërbimeve specifike. Më me rëndësi prej këtyre shërbimeve janë ekspertët që u dërgohen përfituesve për



Rafael Peralta

t'i këshilluar lidhur me aktet legjislative dhe interpretimin e legjislacionit të BE-së, apo që të japin udhëzime për implementimin dhe zbatimin e rregullave të ndryshme administrative. Pas identifikimit të problemit specifik, përfituesi mund të kërkojë nga ATSHI që të dërgojë ekspertët.

ATSHI gjithashtu mund të ofrojë ndihmë në formë të seminareve që t'ia paraqesë dhe sqarojë çështjet e ndërlidhura me legjislacionin e BE-së një audience më të gjërë. Lloji i tillë i ndihmës mund të përqendrohet në nevojat e përfituesit individual ose një grupi përfituesish të cilët ballafaqohen me sfida të ngjashme. ATSHI gjithashtu mund të organizojë vizita studimore që t'u ofrojë mundësi zyrtarëve të administratës për-

fituese të kuptojnë si merren shtetet anëtare të BE-së me çështjet praktike të ndërlidhura me zbatimin e legjislacionit të BE-së dhe çështjet që kanë të bëjnë me bashkëveprimin me palët e interesuara.

Ofrimi i shërbimeve të ATSHI i krijon një mundësi tejet të çmueshme Kosovës për të përfituar nga një sërë shërbimesh që janë dëshmuar si tejet të çmueshme edhe për administratat tjera gjatë avansimit të përpjekjeve të tyre për afrim me standardet europiane. Në të njëjtin aspekt, Kuvendi i Kosovës mund të përfitojë dukshëm nga ATSHI duke marrë parasysh se bën përpjekje në identifikimin e kërkesave të veta dhe kërkon ndihmë nga ATSHI me qëllim të adresimit të tyre.

BE-ja duhet ta marrë rolin udhëheqës në Kosovë

Një valë e dhunës e orekstruar nga ekstremistët shqiptarë në Kosovë përgënjeshtroi pikëpamjen se kjo krahinë e trazuar e Ballkanit është e gatshme për vetëqeverisje të plotë. Njëherësh, administrata e KB-ve nuk ia ka dalur mbanë dot që të sigurojë stabilizimin institucional dhe ekonomik, pa të cilat nuk mund të arrihet vetëqeverisja. E ndodhur ndërmjet jogatishmërisë së saj dhe pakënaqësisë me mbikëqyrjen ndërkombëtare, Kosova ka nevojë për një qasje të re.

Dag Berojter,

Anëtar i Kongresit të ShBA-ve, Republikan nga Nebraska (ShBA), drejtues i Nënkomisionit për Evropë në Komisionin Vendor për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe kryetar i Asamblesë Parlamentare të NATO-s. Ky artikull është botuar me 25 gusht 2004 në gazetën *The Wall Street Journal Europe*.

Me afrimin e kohës kur bashkësia ndërkombëtare, aty nga mesi i vitit 2005, duhet të përballet me diskutimin e statusit të Kosovës, është me rëndësi që të mirret në kosiderim edhe një opcion, i cili do të bënte të mundur integrimet evropiane të këtij entiteti, duke vazhduar njëherësh edhe garantimin e të drejtave të minoriteteve. Kombet e Bashkuara vitin e ardhshëm duhet t'ia kalojnë qeverisjen e vendit Bashkimit Evropian, sipas sistemit të mirëbesimit të KB-ve.

Krijimi i Territorit të Mirëbesimit në Kosovë do të ishte një mekanizëm kreativ, që do të siguronte një qeverisje mjaft të mirë për Kosovën. Njëherazi, do t'ia hapte rrugën Kosovës drejt integritetit në BE, pa paragjykuar se a do të hyjë në union si pjesë e Sërbisë apo si një shtet i pavarur.

Së këndejmi, nisur nga vetë vizioni i BE-së për integrimin e Ballkanit Përendimor në Bashkësi, do të ishte e udhës që të fillohet me procesin mjaft të vështirë të harmonizimit, sa më parë që të jetë e mundur. Mirëpo, Kosova nuk është sikurse vendet e tjera të Evropës, ngase shërbimi

civil i saj, qeveria, dhe gjyqet ende nuk janë të gatshme ta kryejnë punën e harmonizimit. Ndaj dhe BE-ja duhet ta marrë përsipër administrimin civil të Kosovës, ndërsa NATO duhet të mbetet përgjegjëse për sigurinë në krahinë

S'ka pikë dyshimi, se kjo ide ka pak gjasa që të pranohet nga ana e institucioneve të BE-së. Zyrtarët e BE-së do të arsyetohen me faktin se ata tanimë kanë mjaft punë për të bërë, si integrimi i anëratëve të rinjë, kërkesa për ratifikimin e marrëveshjes për draft kushtetutën dhe përgatitjet për të marrë përsipër operacionin paqësor në Bosnje nga NATO. Për këtë arsye nuk mund të pritët edhe aq entuziazëm në Bruksel, sa i takon mundësitë për involvimin e BE-së në një vend të paqëndrueshëm ekonomikisht dhe që nga aspekti politik konsiderohet si fuqi baruti. Megjithatë, një mision mbikëqyrës i BE-së në Kosovë do të bënte të mundur, që në perspektivë të sjellë stabilitet afatgjatë në një nga territoret më të trazuara në Evropë. Prandaj, marrë në përgjithësi përfitimet nga ky mision do të

shpagueheshin.

Administrata e BE-së do të kishite autorizime që të bëjë përshtatjen e sistemit ligjor – të trashëguar nga sistemi komunist Jugosllav – me ligjin modern evropian. Kështu, një rregullore (kod) komercial do të krijonte kushte për investime të huaja të drejtëpërdrejta në Kosovë, që është e një rëndësie kruciale për një ekonomi me një papunësi prej 57%, e cila do ta ketë shumë të vështirë të mëkëmbet. Veç kësaj BE-ja, duke pasur parasysh se Kosova tanimë është duke shfrytëzuar euron si monedhë të veten, do t'ia hapte perspektivën Kosovës për t'u pranuar në Zonën Ekonomike Evropiane, duke zvogëluar kështu jo vetëm shpenzimet për importimin e mallërave, por edhe duke bërë të mundur eksportimin e mallrave nga Kosova në BE. Mirëpo, për të arritur një gjë të tillë ekzistojnë dy pengesa. Së pari, sipas Kartës së KB-ve nuk parashihet mundësia, që ndonjë territor të administrohet nga ndonjë organizatë tjetër ndërkombëtare pos KB-ve. Së dyti, sipas po kësaj Karte, "Sistemi i mbikëqyrjes nuk mund të aplikohet në territoret, të cilat janë anëtare të Kombeve të Bashkuara", ndërsa dihet se Sërbia dhe Mali i Zi janë anëtarë të KB-ve.

Sa i takon çështjes së parë, Karta në mënyrë të qartë parasheh që organizatat ndërkombëtare, përpos KB-ve, mund të zbatojnë dhe përmbushin mandatet e Këshillit të Sigurimit. Veç kësaj neni 81 lejon dhe parasheh që misioni i mbikëqyrjes të administrohet nga më shumë se një shtet, së këndejmi duket se një një

mandat i tillë mund t'i besohet një organizate rajonale siç është BE-ja.

Sa i takon çështjes së dytë, ekzistojnë dy mënyra për të ecur përpara. E para, ka të ngjarë që tërheqja e autoriteteve Jugosllave e ka lënë Kosovën pa kurrfarë qeverisjeje, duke bërë kështu të domosdoshme administrimin ndërkombëtar. Kjo do të hidhte poshtë çdo argument të Beogradit që mbikëqyrja e cënon të drejtën e saj për "soveranitet". Për ndryshe, ka të ngjarë që Sërbia dhe Mali i Zi të pajtohen që Kosova të bëhet territor, i cili do të jetë nën mbikëqyrje, si alternativë ndaj pavarësisht të pashmangshëm të Kosovës, dhe njëherësh mënyra e vetme për mbrojtjen e pakicës sërbë në Kosovë.

Mënyra më e mirë do të ishte që të kjo zgjidhje të pranohet nga vetë kosovarët. S'do mend se shumica shqiptare preferon pavarësinë, pavarësisht nga problemet ndërkombëtare që do të shkatoheshin. Megjithatë, dhuna që shpërtheu gjatë kësaj pranvere provoi se për të mbrojtur pakicat dhe për të siguruar që Kosova do të bëhet një anëtare e përgjegjësme e bashkësisë ndërkombëtare, një formë e administrimit është ende e nevojshme. Për të qenë e sukseshme mbikëqyrja e BE-së, bashkësia ndërkombëtare, e veçanërisht BE-ja do të duhen ta kandisin popullin e Kosovës se kjo Bashkësi do t'ju sigurojë të drejtat dhe prosperitetin e shumëpritur. Së këndejmi, një mbikëqyrje e BE-së, mbase do të ishte rruga më e mirë për t'ia bërë të mundur popullit të Kosovës që t'i gëzojë të gjitha këtë të mira.



Ndryshimet Kushtetuese mund të bëhen

Kosova si entitet e ka tejkaluar gjendjen e vitit 2001, kur u shpall Korniza Kushtetuese, dhe në ndryshimet e propozuara e të miratuara nga Kuvendi i Kosovës, mund të shihen si nismë e mirë që akti më i lartë juridik i Kosovës të shprehë realitetin, dhe të krijojë hapësirë për bartje të plotë të kompetencave që do të bënin përgjegjëse institucionet e Kosovës para zgjedhësve dhe para bashkësisë ndërkombëtare, dhe që do të ishte në interesin e të gjithë qytetarëve pa dallim.

Ramush Tahiri,

Këshilltar i lartë Politik i Kryetarit të Kuvendit të Kosovës



Ramush Tahiri

Secili vend do ti gëzohej ndryshimeve kushtetuese, në këtë do të angazhonte spektër më të gjerë ekspertësh, dhe akti i shpalljes së këtyre ndryshimeve, do të ishte një çast solemn. Kjo nga shkak se me aktin më të lartë juridik të vendit synohet të shprehet gjithë spektri i të arriturave të një shoqërie dhe të krijohen parakushtet e një kornize ligjore, që shprehë synimet e të gjithë qytetarëve të një vendi, për të arritur standardet më të larta demokratike.

Edhe në Kosovë dukej se ishte kështu. Nisma për ti hyrë ndryshimeve kushtetuese u prit shumë mirë. Puna vazhdoi gadi një vit dhe në Mbledhjen Plenare në muajin korrik 2004 Kuvendi i Kosovës miratoi 38 amendamente në Kornizën Kushtetuese të Kosovës nga 42 sa i kishte punuar Grupi Punues. Edhe pse Ar-sim Bajrami kryetar i

Komisionin për çështje legjislative theksoi se "këto amendamente janë larg dëshirës reale të qytetarëve të Kosovës dhe të popullit të Kosovës për të pasur në Kushtetutë të mirëfilltë", çka nënkuptonte se amendamentet janë bërë me ndjenjën e kompromisit, dhe duke iu përshtatur rrethanave ekzistuese, UNMIK-u në deklarimet e veta nëpërmjet zyrtarëve të ndryshëm, shprehu mospajtimin me këto ndryshime, nën arsyetimin se kjo është fushë e rezervuar për te. Më vonë, ndoshta edhe nga fakti se pika 14.3 e Kornizës Kushtetuese thotë se "PSPP-ja me iniciativën e tij ose me një kërkesë të mbështetur nga dy të tretat e antarëve të Kuvendit, mund të bëjë amendamente në këtë Kornizë Kushtetuese", e duke konsideruar se kjo kërkesë është bërë me dorëzim me shkrim të 38 amendamenteve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës, zyrtarë të UNMIK-ut deklaruan se do ti shqyrtojnë amendamentet një nga një dhe PSPP-ja do të merr vendimin.

Pse ndodhin moskuptimet rreth kësaj çështje? Ashtu si edhe me të gjitha të tjerat, hendikep është fakti se në një vend veprojnë dy administrata me dy legjitimitete të ndryshme: institucionet e zgjedhura qeverisëse të Kosovës dhe UNMIK-u si institucion i emëruar. Që të dyja me mandate

pak a shumë të ndryshme. UNMIK-u del i sukseshëm kur e përfundon mandatin dhe i bartë të gjitha kompetencat në institucionet e zgjedhura, legale e legjitime të Kosovës, ndërsa IPVQ-t e Kosovës janë të sukseshme kur i marrin të gjitha kompetencat e plota për të qeverisur vendin.

Janë disa çështje shumë të rëndësishme politike, që ndikojnë në partneritet apo konfrontim, ndërmjet UNMIK-ut dhe Institucioneve të Kosovës, në bashkëqeverisje apo administrim në Kosovë.

Qëndrimi politik, se a po ndërtohet shtet dhe institucione shtetërore në Kosovë, apo po bëhet një administrim kalimtar që siguron paqën dhe qetësinë, pastaj se, pushteti a buron nga vullneti i popullit apo nga fuqia e administrimit ndërkombëtar, përkatësisht e një forme të protektoratit, lidhur me këtë, a mund të marrin vendime e qëndrime thelbore UNMIK-u dhe institucionet e Kosovës, apo këtë duhet ta bëjnë qendrat e vendosjes ndërkombëtare, si është bie fjala KS i OKB, që në bazë të Rezolutës 1244 të vitit 1999 edhe qeveriset Kosova.

Konsideroj se e drejta për të parashtruar kërkesa, si është kjo për ndryshime kushtetuese nuk mund ti mirret askujt e as që kjo kërkesë të shpërfillet, sepse kjo është një e drejtë themelore qytetare, aq më parë nëse bëhet me procedurë e rrugë demokratike, e cila është e arritur e çdo shoqërie.

Vendimi i Kryeadministratorit për ndryshimet kushtetuese

në Kosovë, pritet që të shprehë interesat e UNMIK-ut dhe të qytetarëve të Kosovës, dhe se disa prej amendamenteve do të miratohen menjëherë pas zgjedhjeve, ndërsa të tjerat do të mbesin në shqyrtim të mëtejshëm.

Nuk presë vendim para zgjedhjeve në Kosovë, sepse kjo do të ndikonte negativisht në kontekstin e debateve tash për tash të pakapërcyeshme për ndërtimin e shtetit apo të administrimit ndërkombëtar dhe në ndarjet shqiptaro-serbe në Kosovë dhe jashtë saj. Gjithashtu nuk presë kundërshtim të ndonjë amendamenti të propozuar, sepse asnjëri nuk është në kundërshtim me konventat ndërkombëtare dhe as që prekë të drejtat e komuniteteve që jetojnë në Kosovë... Së fundi 38 amendamentet e miratuara në Kuvendin e Kosovës e të dërguara për nënshkrim te Përfaqësi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-s për Kosovën, janë të ndara njera nga tjetra, të miratuara veq e veq, secili shpreh realitetet e caktuara, dhe hyjnë në fuqi tek pasi të miratohen e nënshkruhen nga Kryeadministratori. Ato që në momentin e caktuar nuk nënshkruhen nuk do të thotë se hudhen poshtë, por do të thotë se mbesin për në periudhë të mëvonshme. Gjithashtu nga përvoja e krijuar e tyre, nuk pres që UNMIK-u dhe institucionet e Kosovës do të hyjnë në një periudhë të polemikave se cili ka të drejtë e cili jo, dhe se Kryeadministratori i UNMIK-ut me vendimin e vet do ti kontribuoj kësaj.

Implementimi i politikave gjuhësore të përfshihet në agjendën politike

Senad Sabović,

Zyrtar për programe, Misioni i OSBE-së në Kosovë.

Misioni i OSBE-së në Kosovë, me datën 14 dhe 15 shtator organizoi një konferencë për politikën gjuhësore në Kosovë. Panelistët dhe pjesëmarrësit, që morrën pjesë ishin përfaqësues me rëndësi të Institucioneve të Përkoshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) – Zyra e Kryeministrit, Ministria e Shërbimeve Publike, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve në Kuvendin e Kosovës, anëtarë të tjerë të Kuvendit të Kosovës – si dhe ekspertë nga Misioni i OSBE-së dhe Zyra e UNMIK-ut për të Kthim dhe Komunitete. Vlen të theksohet se një kontribut të veçantë dhe mjaft të çmuar, në këtë ngjarje kanë dhënë tre ekspertë për të drejtat e minoriteteve dhe të drejtat gjuhësore të minoriteteve: Dr. Fernand de Varennes, profesor në Universitetin e Murdokut (Australi) dhe një nga ekspertët më të shquar në fushën e të drejtave gjuhësore për pakicat, Kllajv Bolldvin, nga Grupi Ndërkombëtar për të Drejtat e Pakicave, dhe Marsel Korthiades, profesor në Universitetin e Parisit dhe anëtarë i Institutit Kombëtar të Gjuhëve dhe Civilizimeve Orientale (INALCO).

Qëllimi i kësaj konference ishte që të definojë qartë problemet aktuale në fushën e përdorimit të gjuhëve zyrtare në Kosovë, si dhe që të bëjë përpjekje për të dhënë sugjerime për krijimin e politikave për tejkalimin e këtij problemi. Në të vërtetë, problemi i përdorimit të gjuhëve të minoriteteve, jo vetëm që është ngritur mjaft shpesh si një çështje shqetësuese nga ana e përfaqësuesve të komuniteteve pakicë në Kosovë, por ka pasur

edhe vërtete për mangësi në zbatimin e politikave gjuhësore në gjithë Kosovën.

Për shkak të raporteve për magësitë në zbatimin e politikës gjuhësore në Kosovë, që përcaktoi qëllimin e kësaj konference, kjo konferencë ndriqoi ca probleme të veçanta me të cilat po ballafaqohet secili komunitet pakicë në fushën e përdorimit zyrtar të gjuhës. Kjo u arrit në saje të pjesëmarrjes aktive të anëtarëve të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve (CRIC), të cilët, sipas Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje në Kosovë kanë bërë të mundur përfshirjen e të gjitha komuniteteve në Kosovë. Në prezantimet e tyre, anëtarët e CRIC hodhën dritë mbi disa probleme konkrete me të cilat komunitetet e tyre ballafaqohen gjatë përdorimit të gjuhës së tyre në institucione dhe në jetën publike.

Pjesa më e madhe e problemeve ka të bëjë me mundësinë për të pasur qasje në institucione të nivelit qendror dhe atij lokal, shtypjen e formularëve dhe dokumenteve në vetëm një gjuhë, mungesën e shërbimeve të përkthimit në institucione, gjë që e bën të pamundur që pjestarët e minoriteteve të kërkojnë shërbime të përkthimit në gjuhën e tyre dhe madje edhe të drujnë që ta flasin gjuhën e tyre në këto institucione. Mungesa e në disa rajone madje edhe mosekzistimi i shenjave të lagjeve, rrugëve dhe shenjave publike në Kosovë në gjuhët e komuniteteve joshumicë është diskutuar si një problem, si teknik ashtu dhe parimor, dhe mjaft shqetësues për komunitete të ndryshme.

Këto probleme janë identifikuar edhe nga zyrtarë ndërkombëtarë që punojnë në Kosovë, në veçanti nga Grupi i Punës së UNMIK-ut për Respektimin e Politikave Gjuhësore dhe nga stafi i OSBE-së nëpër tërë Kosovën. Këto probleme konsiderohen si "mangësi në implementim", ngase dihet mirëfilli se ka më se tre vite që në Kosovë ekziston korniza ligjore për përdorimin e gjuhëve zyrtare. Çështje e vërteta, Korniza Kushtetuese ka dispozita të qarta lidhur me këtë çështje, si dhe ka parashikuar edhe që dispozita të caktuara nga Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale dhe të Minoriteteve dhe Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare të jenë si ligj i aplikueshëm për Kosovën. Për më tepër, Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45 për Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë përcakton edhe detyrimet e autoriteteve komunale sa i takon përdorimit të gjuhëve.

Panelistët dhe pjesëmarrësit theksuan se mangësitë në implementimin e Kornizës Kushtetuese të Kosovës mbi gjuhët vijnë si pasojë jo vetëm e mungesës së

burimeve humane dhe financiare, por edhe e mungesës së angazhimit nga ana e zyrtarëve të komunitetit shumicë për vënjen në jetë të dispozitave mbi gjuhët e minoriteteve. Në dritën e konkluzionit kryesor të konferencës, sipas së cilit problemet dhe shqetësimet e komuniteteve lidhur me përdorimin e gjuhëve të tyre kanë të bëjnë me implementimin joadekuat të kornizës përkatëse ligjore, pjesëmarrësit propozuan që ky problem të zgjidhet me një ligj të posaçëm.

Hartimi i këtij ligji, siç pohuan pjesëmarrësit në fund të kësaj konference, duhet të jetë një nga çështjet me prioritet të qeverisë së ardhshme dhe njëherësh, duhet të përcaktojë qartë rolin dhe përgjegjësinë e institucioneve qendrore dhe lokale si dhe të zyrtarëve për implementimin e politikave gjuhësore. Njëherësh, ky ligj duhet të parashikojë edhe ndëshkime adekuate për ato institucione/ zyrtarë, të cilët nuk i respektojnë dispozitat ligjore si dhe të përcaktojë qartazi mekanizma për të përcjellur zbatimin e këtyre dispozitave.



USAID përqendrohet në ekonominë e tregut dhe institucionet demokratike

Përkrahja e USAID-it (Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar) për Kuvendin është pjesë e dy programeve të gjëra të krijuara për zhvillimin e ekonomisë funksionale të tregut dhe për t'i forcuar institucionet demokratike në Kosovë.

Sharon Hester,

Këshilltore për politika ekonomike në USAID Kosovë.

Me qëllim të arritjes së objektivit strategjik për zhvillimin e ekonomisë së tregut, ne i kemi vendosur këshilltarët në Kuvend që të ndihmojnë me përcaktimin e prioritetëve, shqyrtojnë dhe analizojnë ligjet ekonomike dhe komerciale. Në bazë të ekspertizës së tyre në ligjet komerciale dhe ekonomitë e tjera në tranzicion, ata i këshillojnë anëtarët e Kuvendit për ligjet që kanë të bëjnë me rritjen ekonomike dhe investimet private. Ata punojnë pikësisht me kryesuesit e komisioneve ekonomike për të shqyrtuar, analizuar, dhe amandamentuar çdo ligj që ka ndikim të konsiderueshëm në ekonomi.

Që prej themelimit të Kuvendit më 2002, ata kanë ofruar ndihmën e tyre në më shumë se 40 ligje, duke përfshirë këtu: pensionet themelore, hipotekën, regjistrimin e të drejtave pronësore, tregëtinë e jashtme, telekomunikacionin, mbrojtjen e ambientit, menaxhimin dhe përgjegjësinë publike, falimentimin, asistencën sociale, prokurimin publik, naftën, odën ekonomike, energjinë, marrëveshjet financiare ndërkombëtare, mbrojtjen e konsumatorëve, tregëtinë e brendshme, tatimin për të ardhurat personale, tatimin në profit, tatimin në pronë, administrimin e tatimit, obligimet, konkurrencën, të drejtat pronësore, promovimin e punësimit, lojërat e fatit, dhe xehetarinë.

Lidhur me rritjen e kapaciteteve të bartura të Institucionet

e përkohshme vet-qeverisëse të Kosovës, përkrahja jonë ka rol të natyrës ekskluzivisht këshilluese dhe qëllimi ynë kryesor është ndërtimi i kapaciteteve. Në këtë aspekt, ne marrim pjesë pothuajse në të gjitha takimet e komisioneve ekonomike (të tregëtisë dhe industrisë, buxhetit, financave dhe ekonomisë, transportit dhe telekomunikacionit) me qëllim të sigurimit të trajnimeve gjatë punës për anëtarët e komisioneve dhe dhe personelin e tyre. Këshillat tona kanë të bëjnë kryesisht me vendimet politike, ndikimin në buxhet, përputhmërinë me ligjet tjera, harmonizimin me legjislacionin e BE-së, çështjet e implementimit, dhe projektimin. Duke supozuar se Kuvendi do ta ngrisë cilësinë dhe sasinë e personelit personelit ligjor, ne do të punojmë drejtpërdrejtë me këta shërbyes civil në mënyrë që ata të kenë pasqyrë për punën që e bejmë.

Ndihma jonë për Kuvendin në mënyrë të drejtpërdrejtë përkrahët nga përpjekjet tona në Zyren e Kryeministrit ku ne jemi duke e themeluar një njësi të centralizuar projektimi që përbëhet nga vendorët me përvojë në fushat themelore ekonomike dhe me shkathtësi për hartimin e projektligjeve. Në atë mënyrë qeveria më vonë mund të sigurojë ligje më të shqyrtuara dhe të shkruara mirë për Kuvendin dhe Kuvendi, si edhe parlamentet e tjera në Europë, do të shpenzonte shumë më pak energji për ndryshimin e projektligjeve.

Këshilltarët politikë në vizitë Qeverisë dhe Parlamentit Austriak

Në mbështetje të Institucioneve të Përkohshme të Vetqeverisjes (IPVQ), misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Qeveria e Austrisë kanë organizuar vizitë pune Këshilltarëve Politikë të IPVQ-ve në Vienë prej 4 - 8 korrik 2004.

Besnik Tahiri,

Këshilltar vendor politik, departamenti i demokratizimit, misioni i OSBE-së në Kosovë.

Grupi prej 20 këshilltarëve politikë, përfaqësues të të gjitha ministrive të IPVQ-ës dhe ZKM-ës të cilët ishin pjesëmarrës në një vizitë pune në Vienë si pjesë përbërëse e programit për ngritjen e kapaciteteve.

Qëllimi i kësaj iniciative ishte ndriçimi i rolit të këshilltarëve politikë në procesin administrativ, në aspekt të structures dhe lidhësive, për të konkretizuar përkrahjen e tyre në krijimin e politikave në Ministri, ndarjen e kompetencave mes të emëruarve politikë dhe shërbyesve civil, si dhe bashkëpunimi mbrenda dhe ndërministror. Pjesëmarrësit, përfaqësues të komunitetit shqiptarë, sërbë, boshnjak dhe turk, lajtën një rol të rëndësishëm në vendosjen e komunikimit dhe koncensusit mes Ministrive të IPVQ-ës dhe UNMIK-ut. Gjithashtu ata kryejnë funksion vital në këshillimin e IPVQ-ve mbi çështjet e politikave, në mënyrë që të operacionalizojnë në kohën e duhur dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse Planin për Implementimin e Standardeve për Kosovën.

Në Akademinë Diplomatike në Vienë, këshilltarët politikë vijuan dy sesione të ndara me ekspertët austriak në lidhje me çështjet e lartpërmendura, dhe u njohën me mënyrën e funksionimit të sistemit qeverisës në një shtet të BE-së, në veçanti me rolin e këshilltarëve politikë të ministrave dhe interaksionin me shërbyesit civil. Gjatë kësaj vizite, delegacioni kosovarë pa-

ti disa takime në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Austrisë, Parlamentin e Austrisë dhe me përfaqësues të Zyës së Kancelarisë federale. Të shoqëruar nga një zyrtar nga Sekretariati I OSBE-së, delegacioni vizitoi Qendrën për Parandalimin e Konfliktit pranë OSBE-së si dhe Selinë e Kombeve të Bashkuara në Vienë.

Delegacioni Kosovar gjithashtu vizitoi Parlamentin austriak. Fokusi i takimeve ishin çështjet legjislative, përbërja e grupeve parlamentare, proceset vendim-marrëse, bashkëpunimin me qeverinë dhe shoqërinë civile si dhe historinë e parlamentit austriak.

Gjatë organizimit të aktivitetëve, Misioni I OSBE-së pati bashkëpunim të frytshëm me Zyren e Austrisë në Prishtinë dhe Misionin e Përhershëm të Austrisë në OSBE në Vienë. Aktivitete të ngjajshme pët ngritjen e kapaciteteve parashihen edhe për qeverinë e re të Kosovës që do të dal nga Zgjedhjet e tetorit.

Këshilltarët politikë vlerësuan lartë vizitën si program dobiprurës dhe zhvillimet e tyre të ardhshme profesioniste dhe performancën institucionale. Pjesëmarrësit fuqizuan për tërë programin e ngritjes së kapaciteteve duke filluar nga përmeshja e konrnizës ligjore për këshilltarë politikë, kodit të mirësjelljes, dhe zhvillimin e programeve gjithëpërfshirëse të trajnimit.

Austria e përkushtuar për t'u ardhur në ndihmë institucioneve të Kosovës

Jam jashtëzakonisht mirënjohës ndaj botuesit të "Buletinit Informativ ASI" për rastin që i kanë dhënë Zyrës austriake në Prishtinë për të reflektuar mbi bashkëpunimin tonë me Kuvendin e Kosovës dhe Misionin e OSBE-së në Kosovë. Ne në Zyrën austriake gjithnjë kemi bërë përcapje për t'a mbështetur Kuvendin dhe ky bashkëpunim mujave të fundit ka sjellur edhe rezultatet e para jo vetëm sa i takon mbajtjes së seminareve të nivelit të lartë, por edhe në intensifikimin e bashkëpunimit si në aspektin kuantitativ ashtu edhe atë kualitativ. Deri më tani janë realizuar një sërë iniciativash të rëndësishme. Kësaj rradhe do të ndalem vetëm tek disa nga nismat, të cilat unë konsideroj se janë të një rëndësie të veçantë.

Aleksander Bayerl, Kryesues i Zyrës, Zyra austriake në Prishtinë

Menjëherë pas dialogut të nivelit të lartë Prishtinë – Beograd, të mbajtur në tetor të vitit 2003, Zyra austriake pati kënaqësinë që të ndihojë rreth organizimit të raundit të parë të seminareve mbi Ndryshimin në Menaxhim së bashku me OSBE-në dhe me IPVQ-të, që u mbajt nga data 20 deri me 24 tetor 2003. Ky seminar u përqëndrua në trajnimin e shëfave të kabineteve të IPVQ-ve.

Dy javë, pas pjesës së parë, u mbajt pjesa e dytë dhe më e rëndësishme e seminarit (3-7 nëntor 2003) mbi "Ndryshimet në Menaxhim", kësaj rradhe seminarin u mbajt për Zyrën e kryeministrit dhe ministrat e IPVQ-ve. Edhe pjesa e dytë e seminarit u mbajt në Akademinë Diplomatike në Vjenë. IPVQ-të u përfaqësuan nga Kryeministri Bajram Rexhepi dhe ministrat Ali Sadrija, Zef Morina, Goran Bogdanoviq, Ali Jakupi, Rexhep Osmani, Behxhet Brajshori, Resmije Mumxhiu dhe Milorad Todoroviq. Me këtë rast, delagacioni u takua me përfaqësuesit e Kancelarisë Federale, Ministrin për Punë të Brendshme dhe të Jashtme si dhe me përfaqësuesit e Parlamentit, të cilët u përpoqën që t'ua sqaronin mysafirëve mekanizmat dhe mënyrën e bashkëpunimit të institucioneve austriake. Ky seminar u mbajt në një atmosferë mjaft ngrohtë. Të gjithë pjesëmarrësit, përfshirë edhe kryeministrin morrën pjesë aktivisht në një diskutim, mjaft të gjallë, që u zhvillua gjatë seminarit. Zyra austriake është mirënjohëse për mundësinë që iu dha për të kontribuar në suksesin e këtij seminarin.

Veç kësaj, Zyra austriake, ndihmoi edhe në përgatitjen e konferencës që u mbajt nga data 15 deri me 17 dhjetor 2003 në Qendrën Evropiane Universitare për Studime të Paqes në Stadsllaning në Austri, që u organizua nga Projekti për Drejtësi gjatë Kohërave në Tranzicion të Universitetit të Harvardit së bashku me IPVQ-të. Kjo konferencë ishte mjaft e sukseshme. Në qendër të vëmendjes së kësaj konference ishin metodat dhe teknikat e pajtimit dhe negociatave në rajonet e krizave. Me këtë rast, u morën si shembull rajonet si Afrika Jugore, Amerika Qendrore, Lindja e Afërt dhe Irlanda Veriore. Në këtë ngjarje, që u mbajt në Austri, morën pjesë ekspertë të lartë ndërkombëtarë që të gjithë me përvojë në rajonet e krizave- nga rajonet përkatëse. Pos kësaj, arritja më e madhe e kësaj konference ishte fakti se këtë ngjarje e nderuan me pjesëmarrjen e tyre edhe delegacioni i lartë kosovar, që kishte këtë përbërje: kryetari Ibrahim Rugova, kryeministri Bajram Rexhepi, kryetari i Kuvendit Nexhat Daci, lideri i PDK-së Hashim Thaci, lideri i AAK-së Ramush Haradinaj si dhe përfaqësuesit e "Komuniteteve tjera", të cilët u takuan në këtë pjesë të largët dhe të qetë rurale, për të zhvilluar diskutime të gjata mbi çështje dhe tema nga më të ndryshmet.

Vlen të përmendet se në dhjetor të vitit 2003, vetëm disa ditë para takimit të nivelit të lartë politik në Shtadsllaning, Zyra austriake ndihmoi Fondacionin gjerman Friedrich Nauman për të organizuar një vizitë dy ditore të depu-

tetëve të Kuvendit të Kosovës në Parlamentin e Austrisë në Vjenë. Delegacioni përbëhej nga përfaqësuesit e LDK-së, PDK-së, KK-së, AAK-së si dhe nga KDTP-së, nga komisionet për Financa dhe Ekonomi, për Tregti dhe Industri si dhe komisionit për Buxhet.

Nisma e pestë dhe e fundit u organizua nga Misioni i OSBE-së dhe Qeveria austriake. Ky ishte një seminar për këshilltarët politikë në Akademinë Diplomatike, që u mbajt në Vjenë prej 4 deri me 8 korrik 2004.

Në këtë ngjarje morri pjesë një grup prej 20 këshilltarësh politikë nga ministratë e IPVQ-ve dhe Zyra e kryeministrit, ku përfaqësoheshin shqiptarët, serbët, boshnjakët dhe turqit e Kosovës, të cilët u treguan mjaft aktiv gjatë kësaj nisme, e cila kishte për qëllim që të nxjerrë në pah rolin e këshilltarëve politikë, si në aspektin strukturor ashtu edhe në atë udhëheqës. Seminarin u përqëndrua në ilustrimin dhe demonstrimin e mbështetjes që këshilltarët politikë i japin zhvillimit të politikave në Ministri, ndarjen e kompetencave ndërmjet të emëruarve politik dhe shërbyesve civil dhe në bashkëpunimin si ndërministror ashtu edhe atij brenda ministrisë.

Me këtë rast, theksi u vu në funksionin vital, që kanë këshilltarët për të këshilluar IPVQ-të lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me politikën, të cilat bëjnë të mundur realizimin me kohë dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse Planin për Implementimin e Standardeve për Kosovën. Përpos kësaj, në këtë seminar rëndësi e posaçme



Alexander Bayerl

iu kushtua edhe çështjeve që kanë të bëjnë me BE-në. Thënë më konkretisht, aty u diskutuan gjërë e gjatë mbi Procesin e Stabilizim-Asocimit dhe implikimet për Kosovën. Me këtë rast, u bënë të ditura në mënyrë mjaft gjithëpërfshirëse forcat politike dhe ekonomike që e përbëjnë zhvillimin e BE-së. Ndërsa, modulet dhe diskutimet tjera u fokusuan në zhvillimin dhe evoluimin nga tregu i përbashkët në një treg të vetëm dhe më tutje. Njëherazi, u diskutua gjerë e gjatë edhe për të ardhmen e Evropës dhe zgjerimin e saj në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor.

Fare në fund, Misioni i OSBE-së planifikon organizimin e një aktiviteti të ngjashëm për ndërtimin e kapaciteteve për Qeverinë e re të Kosovës, që do të dalë nga zgjedhjet e Tetorit. Qeveria e Austrisë, në përgjithësi dhe Zyra e Austrisë, në veçanti do të kenë kënaqësinë që edhe kësaj rradhe të japin kontributin e tyre për aktivitete aq të dobishme.

Ministria për Ekonomi dhe Financa ka filluar me dëgjimet buxhetore për vitet 2005 – 2007

Prioritetet buxhetore janë përkrahja e forcimit të ekonomisë dhe krijimi i vendeve të reja të punës.

Këtë muaj Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka filluar me procesin e ndëgjimeve buxhetore me të gjitha agjensionet shpenzuese (organizatat buxhetore), mbi kërkesat fillestare buxhetore për vitet fiskale 2005 – 2007. Dëgjimet buxhetore mbahen çdo vit nga MEF-i, me pjesëmarrjen e Komisioni Buxhetor, për t'iu mundësuar agjensioneve shpenzuese që të sqarojnë kërkesat e tyre fillestare buxhetore dhe të përgjigjen në pyetjet që kanë të bëjnë me financimin e programeve të reja dhe të zgjeruara dhe projekteve investuese, të dorëzuara në korrik të vitit 2004.

Jeannette Sanchez,

Keshilltare për informim në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Ky është viti i dytë që MEF-i është duke i mbajtur dëgjimet me agjensionet shpenzuese kosovare ku përfshihen edhe degët ligjdhënëse qeveritare, ofruesit e shërbimeve publike, njësitë dhe grupet e veçanta.

Tani kërkohet që paralogaritë dhe parashikimet buxhetore të përgatitën për një kornizë afatmesme apo disa vjeçare. Për këtë arsye, buxheti për vitin 2005 përmban edhe parashikimet për vitet fiskale 2006 dhe 2007.

Parashikimet preliminare ekonomike dhe analizat e të hyrave (nga tatimet dhe ato jo tatimore) dhe të donacioneve për një periudhë tre vjeçare janë kryer nga MEF-i në mars të këtij viti. Këto parashikime i kanë marrë në konsiderim edhe ndryshimet në çmime gjatë caktimit të buxheteve operuese dhe programeve të ndryshme shpenzuese publike. Bazuar në këto parashikime fillon edhe procesi i ndarjes së buxhetit nëpër agjensione shpenzuese.

Në qershor, agjensionet shpenzuese i kanë pranuar instruksionet për kompletimin e kërkesave fillestare buxhetore për vitet 2005 – 2007, kurse në korrik atyre i'u janë dërguar indikatorët preliminar mbi kufijtë e buxhetit apo nivelet preliminare të finansimit që nuk duhen të tejkalohen.

Për të shënuar pjekurinë e procesit buxhetor, si një risi dhe ndryshim në planifikimin

e buxhetit, këtë vit është përdorur koncepti i "buxhetimit të orientuar nga rezultatet". Janë disa qëllime dhe përparsi të këtij lloji të buxhetimit. Si një nga më të rëndësishmit është se ju komunikon vendimmarrësve dhe atyre që e bëjnë rishikimin e



buxhetit, rezultatet e pritura nga agjensionet shpenzuese. Si një përparsi tjetër është se i ndërlihd vendimet me mundësitë për zgjedhjen e prioriteve në shpenzime publike.

Kjo mundëson shpenzime më të mëdha në fushat që janë më të rëndësishme dhe ndihmon në kontrollimin dhe zvoglimin e shpenzimeve në fusha me më pak rëndësi dhe produktivitet.

Pjesë të buxhetimit të orientuar nga rezultatet mund të vërehen në "Synimet e Qeverisë për vitet

2005 – 2007 – për forcimin e ekonomisë dhe krijimin e vendeve të reja të punës". Si fusha prioritare që kontibuojnë në arritjen e këtyre synimeve janë: zhvillimi ekonomik, arsimimi, shëndetësia, transporti dhe zhvillimi rural.

fillestare nga Komisioni Buxhetor, Qeveria dhe Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përherëshëm (PSSP).

Për të arritur deri tek buxheti përfundimtar, së pari MEF-i i dërgon dokumentet përfundimtare buxhetore Komisionit Buxhetor. Më pas, Komisioni Buxhetor ia përcjell këto dokumente së bashku me rekomandimet e bëra Qeverisë së Kosovës, e cila i modifikon këto sipas nevojës dhe ia rekomandon Këshillit Ekonomik Fiskal (KEF), Kuvendit dhe PSSP-së për miratim.

Buxheti i Kosovës përpilohet në mënyrë transparente duke involvuar një spektër të gjerë të sektorit publik, përfshirë këtu edhe Zyrën e Kryeministrit, Zyrën e Presidentit, Organizatat qendrore buxhetore, Kuvendin e Kosovës, Kuvendet Komunale dhe PSSP-në.

Është një proces, procedurat operative të të cilit janë të përkufizuara në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Sikurse edhe në periudhat e mëparshme buxhetore, buxheti 2005 – 2007 reflekton punën, profesionalizmin, dhe udhëheqjen e përgjegjshme të atyre që janë të përkushtuar ti shërbejnë qytetarëve të Kosovës. Nga ana tjetër, qytetarët e Kosovës që i paguajnë tatimet, presin që Qeveria të ofroj programe dhe shërbime kualitative.

Simulimi i seancës parlamentare me Asamblëtë Rinore

Nxënës të shkollave të mesme nga tërë Kosova ishin në Zhablak, Mal të Zi në takim i Asambleve Rinore. Ky takim i organizuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë nga 19-26 gusht, mblodhi rinorë nga të gjitha komunitetet. Dy grupe me nga 100 pjesëmarrës nga Kosova ishin prezent. Qëllimi kryesor ishte simulimi i një seance parlamentare. Grupi ishte u informuar për aspektet kryesore të të organizimit dhe funksionimit të Kuvendit të Kosovës, me çrast u janë sqaruar edhe parimet e punës parlamentare dhe të gjitha rregullat tjera procedurale. Gjithashtu ata u pajisën me të gjitha mjetet dhe informacionet e nevojshme për të mbajtur një debat parlamentar mbi një çështje që ka të bëjë me funksionimin multi-gjuhësorë në një shtet të imagjinuar multi-etnik.

Doina Ghimici,
zyrtare e programit, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Skripta për këtë simulim ishte përgatitur me shumë kujdes që të mundësojë një udhëtim ndonëse imagjinar nga realiteti të jetë relevante për punën e asambleve rinore. Objektivi kryesor i simulimit ishte njohja e pjesëmarrësve me parimet demokratike si dhe standardet e të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve. Dhe një tjetër objektivi ishte që pjesëmarrësit të zgjerojnë kreativitetin e tyre në jetën përditshme duke u vendosur në situatë të imagjinuar. Për këtë arsye edhe zgjodh që ata të jenë jashtë Kosovës, në një vend të largët por shumë të bukur që ua dha mundësinë të komunikojnë me njëri tjetrin drejtëpërdrejt apo përmes përkthyesve, që të luajnë dhe krijojnë miqësi, dhe për të harruar sado pak aspektet e pikëllueshme që i ndajnë ata në jetën reale.

Siç ishte paraparë në skriptë, pjesëmarrësit luanin rolin e një parlamenti të imagjinuar në mandatin e tij të tretë por që ka të vendosura të gjitha strukturat dhe qeverinë. Të gjitha bashkësitë etnike që jetonin në atë shtet të imagjinuar ishin të përfaqësuar në parlament, disa prej tyre edhe në Qeveri. Partia multi-etnike "qytetare" (e quajtur "Të gjelbërtit") ishin poashtu në Qeveri. Në ditën e parë të simulimit të parlamentit të imagjinuar ata u mblodhën për të diskutuar temën "arsimimi në shumë

gjuhë" dhe votuan një draft resolute të përgatitur nga Komisioni për Arsim Rini dhe Sport. Ai komision kishte ndërmarrë veprimin në sajë të iniciativës të shoqërisë civile dhe kishte diskutuar çështjen me palët e interesuar në një seri dëgjimesh publike. Gjatë seancës, pjesëmarrësitë debatuan për modalitetet, që u mundësojnë komuniteteve që jetojnë në një vend ku fliten dy gjuhë zyrtare, të komunikojnë mes vete apo së paku kuptojnë sado pak gjuhën e njëri tjetrit. Me faktin që shkolla është vend ku fëmijët do të duhej të fillonin mësimin sistematik të gjuhës zyrtare e cila nuk është gjuha e tyre amtare, parlamentarët e imagjinuar atëherë u pajtuan mbi rolin e arsimit në përmbushjen e funksionit multi-gjuhësorë të shtetit të tyre të imagjinuar. Të ndarë në grupe parlamentare, ata kishin debat demokratik për adaptimin e modelit më të mirë të politikave të arsimit multi-gjuhësorë.

Studentëve iu dhanë role që kontradiktonin realitetet prej nga ata vinin (atyre që vinin nga popullata shumicë u dhanë të luajnë rolet e përfaqësuesve të minoriteteve). Edhe pse kjo paksa i komplikoi detyrat e tyre, i shërbeu më mirë qëllimit të simulimit meqë tinxherët kuptuan se nuk mund ti shfrytëzoheshin zgjedhjet e gatshme, dhe



mënyrat e të menduarit të zakonshëm për ata, por se duhet të mendojnë dhe të kuptojnë që realitete të tjera janë gjithashtu të mundshme. Nxënësitë morrën përsipër sfidat dhe dëshmuan që ata sihin në gjendje të kuptojnë detyra të komplikuar dhe të adaptohen në situatë kretësisht të reja, me tejkalimin e sfidave të para. Mirëpo, mbrenda konrnizës së udhëzimeve të dhëna pjesëtarët e Asambleve Rinore ia dolën mbanë të japin argumente të arsyeshme dhe inteligjente, bile edhe i tejkalonin udhëzimet e dhëna për të zbuluar mënyra të reja për të përmbushur detyrat e vëna para tyre.

Nxënësitë e shkollave të mesme ishin të kënaqur derisa luanin rolet e politikanëve modern

dhe kuptuan që ndërtimi i një të ardhmeje më të mirë, dhe realiteti të ri është në duartë e tyre. Dhe çfarë është më e rëndësishmja, ata duhet të njohin njëri tjetrin dhe ti tejkalojnë rrethanat që i pengojnë ata për tu takuar dhe vënë kontakte mes vete. Pati tinxherë sërëbë nga Kosova që po takonin kolegët e tyre shqiptarë për here të parë në jetën e tyre. Por sërish ia dolën mbanë që të tejkalojnë rezervat që paten në fillim dhe të ulen së bashku. Simulimi përveq që ishte gjë e re që ua mundësonte të luajnë rolet e të 'mëdhenjve', gjë që pëlqehet nga të rinjtë, i përgatiste të mendojnë për kohën kur ata nuk do të jenë më fëmijë, por të mëdhenjë, ndoshta edhe liderë të ardhshëm.

Deklarata e Misionit të ASI-t

Si koordinator e programeve për demokratizim për agjensitë që përkrahin Kuvendin e Kosovës, Iniciativa për Përkrahjen e Kuvendit (ASI) synon që ta forcojë dhe profesionalizojë Kuvendin e Kosovës në zhvillimin e aftësive në mënyrë që sa më parë të shndërrohet në një Kuvend stabil, funksional dhe efikas, i cili në vepron në përputhje me sundimin e ligjit dhe në mënyrë të barabartë në emër të të gjitha bashkësive dhe qytetarëve.

Anëtarët e iniciativës do të punojnë për t'i përqëndruar forcat e përbashkëta rreth një qëllimi të përbashkët që do të mundësojë përparimin në drejtim të arritjes së këtij pikësnyimi. Puna e ASI-it do të përqëndrohet në kulturën politike demokratike duke u mbështetur në njohuritë dhe respektimin e rregullave demokratike të procedurës, transparencën dhe përgjegjësinë ndaj popullit, në zbatimin e rendit legjislativ, mbikëqyrjen e ekzekutivit dhe në respektin ndaj shumëgjuhësisë në Kuvend.

Si një koordinator në mes të agjensive që përkrahin Kuvendin e Kosovës, ASI përkrahë Kuvendin përmes konferencave dhe trajnimeve, seminareve me komisioneve, ndihmës teknike për Kryesinë, për krerët e komisioneve dhe për delegatët e Kuvendit, përmes vizitave të bëra parlamenteve të vendeve të ndryshme, trajnimeve për personelin legjislativ dhe për përkthyesit e Kuvendit. Përpos kësaj, edhe puna e këshilltarëve të Kuvendit dhe komisioneve të tij është pjesë e koordinimit të ASI-t.

Pjesëmarrësit e tanishëm të ASI-t:

Këshilli për Mbrojtjen e Drejtave dhe Lirive të Njeriut - KMDLNJ, Fondacioni Friedrich Ebert Stiftung (FES), Fondacioni Friedrich Naumann Stiftung (FNS), Konrad Adenauer Stiftung, Projekti për Praktikën Parlamentare Lindje-Perëndim (Holandë), Agjensioni Evropian për Rindërtim (AER), Agjensioni SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtarë (USAID) në bashkëpunim me Institutin Kombëtarë Demokratik (NDI), Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) në bashkëpunim me Unionin Ndërparlamentar (IPU), Departamenti i Demokratizimit i OSBE-së dhe Sekretariati i Kuvendit me përkrahjen aktive të zyrës së Kryeministrit, të zyrave të shtyllës së IV të UNMIK-ut UE-së dhe të zyrave përfaqësuese në Prishtinë, siç janë: zyra e Austrisë, Belgjikës, Gjermanisë, Italisë, Holandës, Zvicrës, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



<http://www.kuvendikosoves.org>

<http://www.skupstinakosova.org>

<http://www.assemblyofkosovo.org>

Fotografite nga: OSBE: fq. 1, 2, 3, 4, 6, 8, 10, 11, 15, 16; NDI: fq. 7; EU: pg. 9; Austrian Office: fq 13.

Buletini informativ ASI dëshiron t'i falenderojë të gjithë ata që kontribuan si dhe Sven Lindholm, njësinë e përkthimeve të DD pranë Misionit të OSBE-së në Kosovë, sepse pa përkrahjen e tyre ky Buletin informativ nuk do të ishte në dispozicionin tuaj.

ASI
NEWSLETTER

Rruga Beogradi 32, 38000 Prishtinë

Tel. (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188

kontakt: franklin.devrieze@osce.org

<http://www.osce.org/kosovo>

Pikëpamjet e shprehura nga ata që kontribuan në këtë buletin, iu përkasin vetëm atyre dhe jodomosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e Kuvendit, Misionit të OSBE-së në Kosovë apo të organizatave partnere të ASI-t